



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së <i>PER: [Signature]</i> Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL <i>[Signature]</i>	
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL <i>[Signature]</i>	Data: 08.01.2026 VI-020-697
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës <i>[Signature]</i>	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 02 Nr. 400/01-54104 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
I miratuar më datë: 24.12.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.12.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2025, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 400/01-54104 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12, 40, 44 dhe 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Glllogocit, nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, ne nenet 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB -03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, me të cilin vendim është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Akti është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 24.12.2025, është miratuar më 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Burim Bujupi, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, <i>per</i> Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a, <i>per</i>	
Od:	Erbilin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja /MALS	Dana, 08.01.2026. VI-020-697
Odgovorni službenici:		
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani gradonačelniče,

Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 02 br. 400/01-54104 o osnivanju Opštinskog saveta za bezbedznost u zajednici

Usvojena dana, 24.12.2025.

Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 30.12.2025.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Glogovac, na sednici održanoj dana, 24.12.2025. godine, usvojila je **Odluku 02 br. 400/01-54104 o osnivanju Opštinskog saveta za bezbednost u zajednici.**

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Glogovac, zasnovana na članovima 11, 12, 40, 44 i 53 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, na članu 34, tačka 34.6 Statuta opštine Glogovac, članu 7 Zakona br. 04/L-076 o policiji, na članovima 3 i 4 Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP i -03/2012 MALS o opštinskim savetima za bezbednost u zajednici, odlukom kojom je osnovan Opštinski savet za bezbednost u zajednici.

Akt je usvojen na sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 24.12.2025. godine, sa 23 glasa "za", 0 "protiv" i 0 "uzdržaih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-54104 dt. 24/12 2025



Bazuar në nenin 11, 12, 40, 44 dhe 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040,), nenit 34, pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 24.12.2025, të miratoi këtë:

Administrativa - INCOMING		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritsvo Lokalne Samogore i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data:	30.12.2025	
Date:		
Organizacija:	Nr. Dokument:	Vlera:
VI	020 - 697	

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Miratohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës (Kryesues)
- Laureta Thaqi, Koordinator i KKSB-së;
- Driton Morina, Komandant i Stacionit Policor në Drenas
- Eset Bajraktari, përfaqësues i bashkësisë fetare Islame
- Meriton Sopi, përfaqësues i bashkësisë fetare Katolike
- , përfaqësues i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës
- Zahir Podrimqaku-Subashi, Zyrtar për Barazi Gjinore
- Muhamet Gjoka, Drejtor i Drejtorisë për Arsim
- Arben Haziri, përfaqësues i Këshillit të Prindërve të Arsimit
- Ymerdin Hasani, përfaqësues nga FSK
- Arben Nika, kryesues i Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
- Afrim Gjeli, përfaqësues nga Sektori i Emergjencave
- Afije Veseli, përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Kadire Tahiraj, përfaqësuese e OJQ "QPDG"
- Bajram Ramadani, përfaqësues nga komuniteti i biznesit
- Andi Binaku, përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara (HANDIKOS)
- Anita Curri, përfaqësuese nga Këshilli i Veprimt Rinor Lokal (KVRL)

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Bujim Bujupi

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet dhe është përgjegjës për përgatitjen e planit vjetor të punës dhe zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi; identifikimi i dukurive negative që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimi; bashkëpunimi me policinë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi; bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi; lidhja marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre; të kërkojë nga Kuvendi Komunal i Komunës, financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; përmes komunës të kërkojë nga ndonjë organizatë jo qeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; flon në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së- DSB; flon përfaqësues nga institucionet qeveritare, të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takime të KKSB-së; kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore; mbajtja e takimeve të rregullta, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.

Të nderuar,

Në bazë të ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 44, udhëzimi administrativ Nr.02/2015 Për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 6, kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit Komunal të thërras mbledhje të jashtëzakonshme, për arsye të shqyrtimit dhe miratimit të disa pikave të nevojshme që kërkojnë të trajtohen gjatë këtij viti, disa prej tyre që shërbejnë për Grantin e Performancës Komunale.

Me respekt